

Prishtinë, 07.02.2025

## **Tetë propozime nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) për fituesit e Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, për forcimin e marrëdhënieve ekonomike me Gjermaninë**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) është e përkushtuar për të forcuar më tej raportet bilaterale dhe shkëmbimin tregtar ndërmjet Gjermanisë dhe Kosovës. OEGJK këshillon, mbështet dhe përfaqëson kompanitë gjermane në Kosovë që kërkojnë të zhvillojnë ose zgjerojnë aktivitetet e tyre afariste. Gjithashtu mbështet dhe këshillon kompanitë kosovare, të cilat zhvillojnë tregti me Gjermaninë për një gamë të gjerë të mallrave dhe shërbimeve dhe krijon mundësi për biznes dhe rrjetëzim. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK-KDWV) përfaqëson aktualisht më shumë se 200 kompani.

OEGJK ka qenë dhe vazhdon të jetë organizatë politikisht e paanshme. Për t'i forcuar lidhjet tona ekonomike me Gjermaninë më tutje, OEGJK propozon tetë hapat e mëposhtëm, për fituesit e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Shumica e këtyre propozimeve do të ndihmonin tregtinë e Kosovës me vende të tjera dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

### **Promovimi i Tregtisë dhe Investimeve**

- 1. Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (Prizren):** Përkrahja e vazhdueshme dhe promovimi i Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP) në Prizren për tërheqjen e më shumë investitorëve të huaj në sektorët strategjikë, si teknologjia e informacionit dhe komunikimit (ICT), energjia e ripërtëritshme, arsim profesional, si dhe industria kreative. Me infrastrukturën moderne dhe ekosistemin e zhvilluar për inovacion dhe ndërmarrësi, ITP ofron mundësi unike për investime dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Mbështetja e vazhdueshme institucionale për promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ITP-së do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin ekonomik në Prizren.
- 2. Diplomacia ekonomike:** Zhvillimi i mëtejshëm i diplomacisë ekonomike është një hap i rëndësishëm për forcimin e tregtisë dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Në këtë drejtim, fuqizimi i kapaciteteve të misioneve diplomatike të Kosovës në vende si Gjermania, përmes angazhimit të profesionistëve për çështje ekonomike, do të mundësonte krijimin e mundësive të reja për bizneset kosovare dhe lehtësimin e bashkëpunimeve me investitorët ndërkombëtarë.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Agjencisë së Investimeve dhe Eksporteve (AIE) të krijuar me Ligjin për Investime të Qëndrueshme duhet të krijojë një fushatë për të promovuar dhe përmirësuar imazhin e Kosovës si destinacion për investime të huaja.

### **Kualifikimi i fuqisë punëtore**

3. **Arsimi dhe aftësimi profesional:** Zhvillimi i një strategjie kombëtare mbi identifikimin dhe zhvillimin e profileve deficitare të arsimit dhe aftësimit profesional bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, veçanërisht në sektorët prioritarë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe implementimi i tyre në shkolla profesionale sipas sistemit dual të arsimit.

### **Avokimi për identitetin digjital të Republikës së Kosovës**

4. **Top-Level Domain:** Për të forcuar identitetin digjital të Kosovës dhe përmirësuar integrimin në tregjet ndërkombëtare, është e nevojshme që Qeveria të angazhohet në lobimin për njohjen dhe aprovimin e një domeni të nivelit të lartë (TLD). Kjo do të krijonte sovranitet digjital për Republikën e Kosovës, e cila ka ndikim direkt edhe në sigurinë kibernetike, duke lehtësuar gjithashtu qasjen e bizneseve dhe institucioneve vendore në hapësirën digjitale globale, do të rritej besueshmëria e infrastrukturës digjitale të vendit, dhe do të krijoheshin mundësi të reja për investime dhe bashkëpunim ekonomik.

### **Programi legjislativ 2025**

5. **Hartimi i një Ligji të veçantë për tregtinë elektronike:** Një Ligj i tillë do të ofronte siguri ligjore për bizneset dhe do të poziciononte Kosovën më mirë në garën ndërkombëtare për digjitalizimin e ekonomisë. Gjithashtu krijimi i një task-forcë digjitale për mbrojtjen e konsumatorëve, e cila do të mbikqyrë dhe parandalojë aktivitetet e bizneseve jolegjitime dhe mashtruese, duke siguruar një mjedis më të sigurt për konsumatorët dhe investitorët.
6. **Amandamenti i Ligjit të Punës:** Harmonizimi i Ligjit të Punës me standardet e BE-së dhe zhvillimet e tregut të punës është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi më të qëndrueshëm dhe konkurrues për punëdhënësit dhe punëmarrësit. Në këtë drejtim, përfshirja e dispozitave që reflektojnë ndryshimet në format e punësimit, digjitalizimin dhe fleksibilitetin e tregut të punës do të siguronte një kuadër ligjor më efikas dhe të harmonizuar me praktikatat evropiane. Një qasje e tillë do të lehtësonte integrimin ekonomik të Kosovës dhe do të krijonte mundësi të reja për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm.

### **Përfshirja e Odave Ekonomike bilaterale**

7. Përfshirja e sektorit privat, përmes odave ekonomike bilaterale dhe shoqatave të biznesit, në grupet punuese për hartimin e ligjeve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në komunitetin e biznesit privat është e shumë e rëndësishme, një gjë e tillë do të mundësonte adresimin më të saktë të nevojave dhe sfidave me të cilat përballen ndërmarrjet.
  
8. **Rifunksionalizimi i Këshillit Ekonomiko-Social:** Rifunksionalizimi i këtij Këshilli është i domosdoshëm për të vazhduar dhe zhvilluar më tutje dialogun social në Republikën e Kosovës për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Republikën e Kosovës.